

343.541:343.132

Driton Islami<sup>1</sup>

**MASAT OPERATIVO-TAKTIKE KRIMINALISTIKE DHE  
VEPRIMET HETIMORE PËR ZBULIMIN E KRIMINALITETIT  
SEKSUAL**

**ОПЕРАТИВНО-ТАКТИЧКИ КРИМИНАЛИСТИЧКИ МЕРКИ  
И ИСТРАЖНИТЕ ПОСТАПКИ ВО ОТКРИВАЊЕ НА  
СЕКСУАЛНИОТ КРИМИНАЛ**

**PROVISIONS OPERATIVO- TACTICAL FORENSIC AND  
INVESTIGATIVE ACTIONS RECOVERY SEXUAL CRIME**

**Abstract**

The object of this paper is an examination of discovery and enlightenment of sexual crime that has a great importance in combating but also in the prevention of this phenomenon dangerous criminal. The event, operative- tactical forensic and investigative actions to detect and brightness of this type of crime makes it possible to reduce the presence of 'dark number' 'and also means a more successful protection against this form of criminality. At this stage of the preliminary procedure develop a dense and operational activity of the police and other entities, which take a number of actions in terms of detection of criminal offenses against sexual integrity.

In preliminary proceedings the disclosure of criminal acts and their perpetrators, we could say that it is very important stage in the process of detection and prevention of crime in general is and in the detection and prevention of crimes against sexual integrity. In this regard D. Dimitroviq, rightly says that 'preliminary procedure helps develop and conduct of the proceedings'

Given the fact and undeniable role of the police in the detection of crimes

---

<sup>1</sup> Autori është master i shkencave juridike-penale pranë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe është ligjërues në Kolegjin Universitar “FAMA” në Prishtinë në departamentin e Kriminalistikës.  
E-mail: ma.sc.dritonislami@hotmail.com.

against sexual integrity and perpetrators their next stop in presenting and handling the work and activities of this body very important in detecting this form of criminality, also in this regard we will also talk about the role of prosecutor and other bodies involved in this important stage. In this way will be analyzed and dealt with measures acts, operative - tactical, and other actions investigative detection and clarification of offenses against sexual integrity, such as: time and place of the event, inspection, audits, taking of evidence, detection and treatment of perpetrators of crimes against sexual integrity, tools and methods in the detection and illumination criminal offenses against sexual integrity, examination of the crime scene, the fingerprints of the perpetrator etc.

### **1. Roli i policisë dhe i prokurorisë në zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale kundër integritetit seksual**

Policia është organ shtetëror që bën pjesë në sistemin e drejtësisë penale të një vendi. Roli i policisë brenda sistemit të drejtësisë është i pashmangshëm, pasi që siç thekson me të drejtë dr. Ejup Sahiti se në luftimin e kriminaliteti “policia gjendet e para në vijë të frontit”.<sup>2</sup>

Në zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale kundër integritetit seksual, si një ndër format e kriminalitetit, roli i policisë është i pashmangshëm. Siç dihet policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe për sigurinë e rendit juridik. Policia ka përjetuar ndryshime dhe evoluime të mëdha në fazat e zhvillimit të saj. Kurse kërkimet më të reja të aktivitetit policor, si sektor i posaçëm i kontrollit shoqërorë, tregojnë se aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin e parandalimit.<sup>3</sup>

Pra, nga kjo shihet se policia është e krijuar me ligj, vepron sipas ligjit e mbron atë duke mbrojtur të mirat e individit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Dihet mirëfilli se me paraqitjen e kriminalitetit si dukuri negative e shoqërisë kanë pasur edhe masat përkatëse të shoqërisë dhe të shtetit në mbrojtjen e vlerave nga format e ndryshme të sulmimit kriminal. Natyrisht kuptohet, se në një shoqëri të organizuar dhe në shtet në përgjithësi janë të përcaktuara kompetencat dhe detyrat e organeve përkatëse të zbulimit, parandalimit, gjykimit, respektivisht të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi. Roli i organeve të drejtësisë penale, pra edhe i policisë në zbulimin dhe ndriçimin e këtij lloji të kriminalitetit është i pazëvendësueshëm.

---

<sup>2</sup> E. Sahiti, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005, f. 189.

<sup>3</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e kriminit*, Prishtinë, 2006, f. 23.

Metodat bashkëkohore në luftë kundër kriminalitetit përbëjnë aspektin parandalues e represiv dhe se zbatimi i tyre nga organet e specializuara garanton zbulimin efektiv të veprave penale të gjitha llojeve, duke përfshirë edhe veprat penale kundër integritetit seksual. Çdo vepër penale ka specifikat e saj, prandaj këto specifika përcaktojnë edhe metodat kriminalistike, teknike e taktike që duhet zbatuar në situatën konkrete kriminalistike.

Në rastin e zbulimit, ndriçimit të kriminalitetit seksual, për hulumtimin dhe sqarimin e tyre vijnë në shprehje të gjitha degët e kriminalistikës, si taktika kriminalistike, teknika kriminalistike dhe metodika kriminalistike.

Metodika kriminalistike, në zbulimin, ndriçimin dhe sqarimin e veprave penale dhe kryerësve të kriminalitetit seksual, paraqet një formë të veçantë të zbatimit profesional të masave taktiko-kriminalistike dhe të metodave dhe mjeteve të tjera teknike-kriminalistike. Të gjitha këto veprimtari nën mbikëqyrjen e policisë, më vonë masat dhe veprimet që urdhëron prokurori i shtetit në fazën paraprake hetimore dhe në procedurën gjyqësore, janë të kushtëzuara nga bashkëpunimi i organizuar i të gjitha këtyre organeve në zbulimin, ndriçimin dhe gjykimin e kryerësve të veprave penale. Një rol shumë të rëndësishëm ka prokuroria e shtetit si organ i pavarur, e cila është përgjegjëse për hetimin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*), apo edhe me propozimin e të dëmtuarit, po ashtu prokurori i shtetit është përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes së kryerësve të tyre dhe për mbikëqyrjen e policisë gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për mbledhjen e të dhënave e informacioneve për fillimin e procedurës penale.<sup>4</sup>

Me zbulimin e kriminalitetit seksual kuptojmë një proces me të cilin me hulumtime dhe studime të informacioneve ekzistuese arrihet deri te informacionet dhe sqarimet e reja lidhur me krimin e paraqitur. Zbulimi konsiston në gjetjen dhe mbledhjen e informacioneve potenciale të fshehura mbi kriminalitetin seksual, si dhe rrethanat e tjera të rëndësishme për rastin e trajtuar. Zbulimi dhe ndriçimi i veprave penale kundër integritetit seksual i përket veprimtarisë së policisë primare por edhe organeve të tjera të represionit- prokurorisë dhe gjykatës.

Zbulimi i veprave penale ka për qëllim që nga dyshimet më të ulëta të arrihet te shkalla më e lartë e dyshimit, gjegjësisht dyshimit të

---

<sup>4</sup> E. Sahiti, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005, f. 81.

bazuar mbi krimin dhe kryerësin. Kjo veprimtari kryhet në kuadër të procedurës paraprake. Hapja dhe zhvillimi i procedurës paraprake është e lidhur me kushtin e paraqitjes së bazave të dyshimit mbi ekzistimin e veprës penale.

Veprimtaria zbuluese përbëhet nga aktivitetet e organeve repressive, që nga dyshimi fillestar mbi mundësin e ekzistimit të veprës penale deri te dyshimi i bazuar mbi ekzistimin e kriminalitetit seksual. Kjo veprimtari zbatohet me mbledhjen e informacioneve, të dhënave, verifikimin e tyre, ngritjen e versioneve, krahasimin e tyre, procedimin e eliminimit dhe masa të tjera.

Pra, për veprat penale kundër integritetit seksual si vepër penale dhe për kryerësin e dyshuar duhet mbledhur fakte të mjaftueshme për të zhvilluar dhe kryer procedurën përkatëse gjyqësore. Për zbulimin, ndriçimin dhe sqarimin e veprave penale kundër integritetit seksual dhe kryerësit e tyre duhet gjetur të dhëna relevante nga burimet e ndryshme të informimit dhe duhet vlerësuar cilësia dhe rëndësia e tyre, me ç'rast duhet pasur parasysh që një numër i informacioneve e ka cilësinë e "fshehur" andaj duhet kujdes për ta zbuluar.

Sqarimi i veprave penale kundër integritetit seksual, i përket kryesisht shqyrtimit të së kaluarës dhe kryesisht fillon në vendin e kryerjes së krimit ku këqyrja e vendit të ngjarjes është një nga veprimet themelore. Me masa dhe veprime kriminalistike, teknike-taktike, me këqyrje, zbulohen dhe fiksohen informacionet nga burimet materiale të informimit, respektivisht nga gjurmët e lëndët e veprës penale.

Fazën fillestare informative të veprave penale kundër integritetit seksual e përbëjnë indicet e karakterit orientues-eliminues që janë në funksion të hapjes së hetimeve. Këto informacione mund të paraqiten si prova në kuptimin joformal dhe operativ, por edhe si prova në kuptimin formal dhe procedural. Procedura paraprake e organeve të policisë, që kryhet në bazë të dyshimit të bazuar ose nga fillimi i bazave të dyshimit, kuptohet si përpunim kriminalistikë.

Përpunimi kriminalistik është tërësia e masave dhe veprimeve të planifikuara metodologjike që ndërmerr policia në procedurën paraprake lidhur me veprën penale ose ngjarjen penale, me qëllim që bazat e dyshimit deri ku është arritur me kontrollimin kriminalistikë të ngrihen në shkallë më të lartë të besueshmërisë, që do të mundësojë marrjen e vendimeve të caktuara penalo-juridike.

Ç'është e vërteta, është e nevojshme që bazat e dyshimit me përpunim kriminalistikë të transformohen në dyshime të bazuara. Në

përpunimin kriminalistikë bëjnë pjesë: masat dhe veprimet që ndërmerren për zbulimin e veprës penale dhe kryerësit, që kryerësi dhe bashkëvepruesi të zbulohen dhe të kapen, që të pengohet ikja dhe fshehja e tyre, që të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët dhe lëndët e veprës penale që mund të shfrytëzohen si prova në procedurën penale, që të mblidhen të gjitha informacionet me interes ose të dobishme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale.

Ndërmarrja e veprimtarisë operative nuk varet nga kërkesa e prokurorisë kompetente ose nga ndonjë kusht tjetër formal, por fillon sipas vetiniciativës së policisë.

Shkaku për ndërmarrjen e kësaj veprimtarie është të mësuarit për dyshimin e bazuar se është kryer vepra penale, për të cilën ndjekja bëhet sipas detyrës zyrtare. Fjala është për veprimtarinë e policisë që është e drejtuar në zbulimin, mbledhjen, sigurimin dhe nxjerrjen e provave mbi fakte relevante, zbulimin e kryerësit dhe sigurimin e pranisë së tij në këto procedura.

Nga kjo që u tha mund të konstatojmë se roli i policisë, i prokurorisë, paraqet një veprimtari të dobishme, në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, po ashtu në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, duke ndërmarrë masa dhe veprime konkrete në zbulimin, parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, por edhe të kriminalitetit seksual.

## **2. Karakteristikat kriminalistike të marrëdhënieve seksuale me dhunë**

Praktika gjyqësore provon faktin se përqindja më e madhe e kryesve të krimeve seksuale, e veçmas të veprave penale dhunimi u përket personave të rinj. Pothuajse  $\frac{3}{4}$  e kryesve të dhunimit ju përkasin personave nën moshën 30 vjeçare. Çdo i shati kryes është i mitur. Nëse ju referohemi statistikave që merren me hulumtimin e krimeve seksuale, tregojnë se afro  $\frac{2}{3}$  e kryesve kanë pasur të kryer 8 ose me pakë klasë të shkollës fillore.<sup>5</sup>

Duke ju referuar dr. Skënder Begeja<sup>6</sup>, thekson se situatat më tipike që karakterizojnë marrëdhëniet seksuale me dhunë janë: fajtori, kur ndodhet në një takim feste (mbrëmje, martesë, ditëlindje etj.) ose në një vend publik (disko klub, restorant, plazh, etj.) shfrytëzon besimin

---

<sup>5</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 308.

<sup>6</sup> S. Begeja, *Kriminalistika Tiranë*, 2004, f. 619-620.

ose, shpreh, gjendjen euforike të së dëmtuarës ose të dëmtuarit të shkaktuara nga pija alkoolike, e çon atë në një vend të fshehtë, pa njerëz dhe kryen aktin seksual me dhunë; fajtori, i pajisur me mjete të transportit (automjet, motoçikletë, varkë), pasi që takon viktimën, propozon të shkojnë në një vend të caktuar dhe pastaj, pavarësisht nga vullneti i saj (i tij), e çon në një vend ku nuk ka njerëz dhe e dhunon atë; fajtori e takon rastësisht viktimën në një vend pa njerëz (pyll, park etj.) dhe e sulmon papritur për të kryer marrëdhënien seksuale; fajtori e takon rastësisht, e ndjek qëllimisht viktimën e mitur (në oborr, në institucione shkollore, në rrugë etj.) dhe, duke e mashtruar (gënjyer), e çon në një vend të veçuar, shumë të largët, të humbur dhe kryen aktin seksual.

Situata të veçanta kriminale përbëjnë rastet kur marrëdhëniet seksuale kryhen nga një grup personash duke përdorur format e lartcekura. Situata tjera kriminale paraqiten edhe rastet kur viktimja gjendet në gjendje pazotësie për t'u mbrojtur duke përdorur këto mënyra: me anë të dehjes, me anë të përdorimit të barnave narkotike, të lëndëve psikotrope, me anë të sugjestionimit, të hipnozës; me rrahje, goditje, lidhje duarsh e këmbësh, shtrirje për toke, kapje për flokësh etj.; me anë të mashtrimit duke dhënë para, dhuruar etj.

Mposhtja e kundërshtarit të viktimës nga dhunuesit bëhet edhe duke e kanosur, kërcënuar ose frikësuar atë me armë zjarri (të ftohta apo zjarri), aty për aty, për ta detyruar atë t'i nënshtrohet qëllimit që ka dhunuesi ndaj viktimës.

Në shumicën e rasteve, kur dhunuesi është maniak i dhënë pas seksit, bën përgatitjet më parë: e zgjedh vendin, përgatit mjetet e nevojshme për ta kthyer viktimën në gjendje të pazotësisë, ndjek viktimën kudo që shkon. Këto mjete janë karakteristike, gjithashtu, edhe për personat e sëmurë psikikë.

Ndër të tjera kemi edhe metodat tipike për mbulimin e veprave penale kundër integritetit seksual siç janë: përpjekjet e fajtorit për zhdukjen e gjurmëve të krimit (njollat e spermës, të gjakut, gjurmët e ardhjes në një vend të caktuar etj.); maskimi i fajtorit (duke vënë maskën ose duke e mbuluar kokën) për të mos u njohur nga viktimja.

Rëndësi të madhe kriminalistike kanë gjurmët dhe ndryshimet në mjedisin material, që kanë lindur si rrjedhim i kryerjes së krimit. Në banesa këto mund të jenë sende tualeti të femrës ose të burrit të hedhura; shtresa e dyshekut, mobiliet e rena për toke; në dyshek, në çarçafë, në mbulesa dhe në tesha njolla sperme, gjaku, në enët, në sendet e përdorimit shtëpiak gjurmë gishtash të dhunuesit; në dysheme gjurmë

këmbësh etj. Në vende të hapura mund të ketë gjurmë dhe ndryshime, si shkelje dheu, këputje bimësh, bari; në tokë mund të gjenden gjurmë këmbësh, të shputës, sende të ndryshme dhe objekte të lëna qoftë nga fajtori, qoftë nga viktimi.<sup>7</sup>

Personat që kryejnë krime seksuale, shpesh marrin pije alkoolike, bëjnë jetë parazite, janë imoral, të korruptuar, të dhënë pas seksit, të egër, egoist etj. Ka edhe raste kur këto krime i kryejnë personat që vuajnë nga sëmundjet e ndryshme psikike.

Motivi kryesor i kryerjes së krimeve seksuale është që fajtori të kënaq pasionin e tij seksual. Megjithatë, ka edhe motive të karakterit tjetër, siç është rasti kur dashnori i gënjyer kërkon të hakmerret.<sup>8</sup> Në praktikën kriminalistike, ka edhe raste kur marrëdhëniet seksuale me dhunë kryhen edhe për motive vagabonde, shpesh nga grupe vagabondësh, zakonisht nga personat që kërkojnë ta paraqesin vetën se janë bërë burra.

Viktimat e marrëdhënieve seksuale me dhunë, zakonisht janë femra që gënjehen lehtë, të pakujdesshme mendjelehta dhe të përdala, rrethanat të cilat sjellin me vete edhe një situatë viktimogjene (sulmin ndaj tyre).<sup>9</sup>

### **3. Veprimtaria hetimore dhe masat kriminalistike në zbulimin e kriminalitetit seksual**

Pavarësisht nga kompetencat dhe detyrat që ka prokurori i shtetit në ndjekjen e kryerësve të veprave penale të ndryshme, pra edhe kriminalitetit seksual, shumë punë dhe veprime duhet t'i kryejë policia. Prandaj, është me interes analizimi i detyrave të policisë me rastin e sqarimit të veprave penale kundër integritetit seksual.

Në hetimin e krimeve seksuale, duhet ndjekur një radhë e caktuar, të cilat duhet të kryhen këto veprime hetimore, që detyrë e hetuesisë do të jetë që me pyetje e së dëmtuarës, këqyrja e vendit të ngjarjes, ekspertiza mjekësore-ligjore, dhe psikiatrike-ligjore i të dëmtuarës, pyetje e dëshmitarëve, ekzaminimi mjeko-ligjore i personit të dyshuar, pyetja e personit të dyshuar (të pandehurit).

Pra të vërtetohet se në rastin konkret a ka qenë e mundur të kryhet marrëdhënia seksuale me dhunë dhe a ka mundur të kryhet. Këto veprime hetimore, së bashku, bëjnë të mundur të mbledhin të dhënat,

---

<sup>7</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004., f. 621.

<sup>8</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e kimit*, Prishtinë, 2006, f. 309.

<sup>9</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, f. 621.

në bazë të të cilave krijohet pasqyra e ngjarjes konkrete, nëse ajo ka ndodhur me të vërtetë.

Çështjet kryesore kriminalistike-taktike të cilat duhet shtruar dhe zgjidhur me rastin e sqarimit të marrëdhënieve seksuale me dhunë janë: ku është kryer marrëdhënia seksuale me dhunë; a është kryer marrëdhënia seksuale me dhunë me përdorimin e fuqisë psikike apo fizike; a ekzistojnë në vendin e ngjarjes gjurmë rezistente; a ka gjurmë dhe lëndime në trupin e viktimës; a ka gjurmë dhe dëmtime në rrobat e viktimës; a ka gjurmë dhe lëndime në trupin e kryerësit (personit të dyshuar); a ka gjurmë në rrobat dhe në këpucët e personit të dyshuar; a ka bërtitur viktima ose kur dhe kush e ka dëgjuar atë; kujt i ka folur e dëmtuara për ngjarjen; sa kohë ka kaluar prej kohës së kryerjes së veprës penale; a ka qenë e dëmtuara te mjeku para se ta ketë bërë kallëzimin penal dhe çka i ka thënë mjeku; a e ka njohur e dëmtuara kryerësin edhe përpara dhe çfarë raportesh kishin pasur me të.

Duke u bazuar në indicie por edhe në fakte të tjera, tërësia e veprimit në zbatimin e masave operative-taktike kriminalistike kërkon planifikimin e tyre për t'u evituar puna e paorganizuar. Andaj, zgjidhja e këtyre pyetjeve nga kriminalisti dhe gjetja e përgjigjeve të këtyre pyetjeve do të çoi në zbulimin e kryerësit të veprave penale.

#### **4. Kallëzimi penal dhe ndjekja e kryerësve**

Në zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të kriminalitetit seksual përdoren mjete dhe metoda të ndryshme. Në këtë aspekt me rëndësi të veçantë janë burimet e njoftimit për veprën penale - krimet seksuale, sidomos në rastet e detyrimit të kallëzimit penal për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Detyrimi për të kallëzuar nuk qëndron kur rrethanat e faktit nuk lejojnë subjektin që të konstatojë saktë se çfarë lloj vepre penale është konstatuar.

Kallëzimi penal është “akt me të cilin, sipas rregullit, mund ta paraqesë i dëmtuari ose cilido nga qytetarët dhe për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, duhet ta paraqesin organet shtetërore, në rend të parë policia, kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra penale. Kallëzimi i drejtohet prokurorit të shtetit kompetent (edhe kallëzimi i qytetarëve i cili i adresohet policisë duhet të merret në konsiderim), i cili, pas shqyrtimit të tij, vendoset nëse duhet ta hedhë atë, apo të zbatojë hetimin apo të paraqes akuzën”<sup>10</sup>.

---

<sup>10</sup> E. Sahiti, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005, f. 107.



Gjithashtu, duhet theksuar se veprimtaria e policisë rreth zbulimit të veprave penale, pra edhe veprave penale kundër integritetit seksual, të gjetjes së kryerësit të saj dhe sigurimit të provave kurorëzohet me kallëzimin penal që ky organ ia bën prokurorit kompetent. Dihet se në kallëzimin penal, në të shënohen provat që ka mësuar me rastin e mbledhjes së njoftimeve. Po ashtu, së bashku me kallëzimin penal dërgohen edhe sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e marra, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra si dhe materialet e tjera që mund të kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.<sup>11</sup> Pra, nëse pas paraqitjes së kallëzimit penal policia mëson se ka fakte të reja, prova ose gjurmë të veprave penale kundër integritetit seksual, ajo ka për detyrë të vazhdueshme të mbledh njoftimet e nevojshme dhe raportin për këto si plotësim të kallëzimit penal t'ia dërgoj prokurorit të shtetit.

Kuptohet, mbledhja e provave me rastin e kriminalitetit seksual është më e ndërlikuar dhe zbatimi i mjeteve dhe i metodave kriminalistike dhe atyre hetimore është specifike. Në të gjitha rastet e provuarit të veprave penale kundër integritetit seksual, kur nga kallëzimi penal nuk mund të përcaktohet se pretendimet e përfshira në të janë të mundshme ose të dhënat në kallëzimin penal nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e hetimeve dhe veçanërisht kur kryerësi është i panjohur ose prokurori ka dëgjuar se është kryer vepra penale, nëse vetë prokurori nuk është në gjendje të ndërmarrë këtë, kërkon nga policia të mbledhë të dhënat e duhura.<sup>12</sup>

Tek veprat penale kundër integritetit seksual gjegjësisht në marrëdhëniet seksuale me dhunë kallëzimi penal nga viktimat ose nga e dëmtuara paraqet një problem të rëndësishëm së veçantë. Në këtë drejtim gjithëherë duhet pasur parasysh faktin se objekt i dhunës mund të jetë femrat e zhvilluara në moshë normale, vajzat e mitura (madje 4-5 vjeçare) që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, grat të moshuara etj. Gjithashtu një numër i kallëzimeve penale është i rremë (30- 40 %)<sup>13</sup>, e që nga kjo del se, sipas kësaj përqindje të kallëzimeve të rrema bëhen nga të sëmurat psikopate, hysterike, më sëmundje patologjike ose nga ato që kanë kryer marrëdhënie seksuale nga dëshira, por në polici i paraqesin kallëzimet penale si dhunime. Në këtë aspekt motivet që i shtyjnë, në disa raste, kur kallëzimet penale paraqiten si të rrejshme, burimin e kanë

---

<sup>11</sup> Po, aty, f. 191.

<sup>12</sup> E. Sahiti, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005, f. 192.

<sup>13</sup> Shih: V. Vodeneliq, *Kriminalistika*, Prishtinë 1970, f.520.

te xhelozia, te mungesa e dashurisë nga njëra palë, te kapja në flagrancë e tij. Praktika kriminalistike ka treguar se ndodhin edhe këto raste. Prandaj, çdo kallëzime penal që paraqitet për marrëdhëniet seksuale duhet të analizohet dhe të shqyrtohet me shumë vëmendje nga ana e policisë.<sup>14</sup> Në këtë drejtim, problem esencjal në rastet e kallëzimeve penale nga organet e policisë duhet të jetë ajo se marrëdhënia seksuale me dhunë ka qenë me dhunë apo jo.

Praktika ka treguar se femrat që paraqesin kallëzime penale nuk e paraqesin personin që ka kryer aktin seksual me dhunë, por e paraqesin dikë tjetër. Kështu, për shembull, kur ajo ka mbetur shtatzëne me një person në kohën kur bashkëshorti i saj ndodhej në (shërbim ushtarak ose kur gjendet në mërgim duke punuar), paraqet kallëzime të rrejshme për ndonjë person tjetër se ka dashur ta dhunojë. Prandaj organet e policisë duhet t'i shqyrtojnë me vëmendje, andaj vetë fakti që femrat fajësojnë një person nuk duhet të konsiderohet si provë e pakontestueshme se është kryer vepra penale. Sipas nenit 69<sup>15</sup> të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, policia heton veprat penale dhe ia raporton ato prokurorit të shtetit sa më shpejtë që të jetë e mundur. Në paragrafin 2 të këtij neni thuhet se prokurori i shteti dhe policia punojnë bashkërisht gjatë hetimeve.

Ndërkaq, në nenin 3 të këtij kodi thuhet se, prokurori i shtetit drejton dhe mbikëqyrë punën e policisë gjatë hetimeve. Neni 70, i Kodit të Procedurës Penale, paragrafi 1, bën fjalë për veprimet hetimore të policisë, pas pranimin të informatave për një vepër penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshime të arsyeshme që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare të jetë kryer. Kurse në paragrafin 2 të këtij neni thuhet se: policia heton veprat penale dhe ndërmerret të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arresti, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat e tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurën penale. Paragrafi 3, thekson se policia është e autorizuar që: të mbledhë informata nga personat; të kryejë kontroll të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre; të kufizojë lëvizjen në zona të caktuara për kohën kur ky veprim është urgjent i nevojshëm; të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të vërtetuar

---

<sup>14</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, f. 621.

<sup>15</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 69.

identitetin e personave dhe sendeve; të sigurojë ekzaminim fizik të dëmtuarit; të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjekoligjor të atyre provave nga laboratorit i mjekësisë ligjore; të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarin e mundshëm; të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të gjetur kryerësin dhe për të parandaluar kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja; dhe të ndërmarrë hapa dhe veprime të tjera të nevojshme. Çdo veprim që ndërmerr policia duhet të përpiloj procesverbal, shënim zyrtarë por edhe fotografi.

Të gjitha këto masa dhe veprime që ndërmerren në zbulimin dhe të provuarit e veprave penale kundër integritetit seksual, që janë kompetencë e policisë, por edhe prokurorisë së shtetit, kanë një rëndësi të madhe në procesin e luftimit dhe të parandalimit të veprave penale kundër integritetit seksual.

### **5. Planifikimi i hetimeve dhe verifikimi i versioneve hetimore**

Policia si organ publik i cili ka për detyrë, në bazë të dhënave që pasqyrohen në kallëzimin penalë, në fazat e hetimit duhet të ngrit këto versione: nëse është përdorur dhuna ndaj viktimës; nëse dhunën e ka përdorur personi që tregohet nga ana e viktimës; dhuna nuk është përdorur, por ka pasur marrëdhënie seksuale me vullnetin e lirë. Marrëdhënie seksuale nuk ka pasur, kallëzimi i së dëmtuarës ose i të dëmtuarës është i rremë.

Planifikimi i hetimit dhe verifikimi i këtyre versioneve ka disa specifika. Ai kryesisht varet nga disa rrethana tipike që lindin në fillim të hetimit: kur viktimja e njëj fajtorin dhe kur fajtori është i panjohur fare. Në rastin kur personi njihet nga viktimja, para policisë shtrohet si detyrë verifikimi nëse ai ka kryer veprën penale. Po, ashtu verifikohen edhe kundërversionet që ngre fajtori i prezumuar se është i pafajshëm. Rastet nga praktika provojnë se pjesa dërmuese e personave të denoncuar, thonë se marrëdhënia seksuale ka qenë me vullnetin e viktimës. Me këtë rast kur bëhen hetimet është në interes të verifikohen pretendimet e viktimës por edhe të fajtorit të akuzuar në mënyrë që hetimi të ketë suksese.

Kur policia verifikon versionet e karakterit vullnetar të marrëdhënieve seksuale, para së gjithash duhet të sqarohet fakti nëse i dyshuari ka përdorur dhunë ose kanosje për kryerjen e marrëdhënies seksuale. Për këtë qëllim, ai bënë këqyrjen e vendit të ngjarjes, kontrollimin në

banesën e të dyshuarit, këqyrjen e teshave, këqyrjen paraprake të personit të dyshuar dhe të viktimës, pyetjen e dëshmitarëve që kanë parë ngjarjen dhe dëshmitarëve të tjerë. Kur personi i dyshuar pohon faktin e takimit me viktimën, por mohon kryerjen e aktit seksual, është me rëndësi të verifikohen: këqyrja paraprake mjeko-ligjore e viktimës dhe personelit të akuzuar për kryerjen e aktit seksual me dhunë; kërkimi i provave të ardhjes dhe të qëndrimit të viktimës dhe personit apo personave të dyshuar në vendin e ngjarjes; pyetja e viktimës mbi rrethanat e krimit.

Në rastin kur personi i dyshuar nuk njihet nga viktimja, verifikimi i versioneve hetimore ka disa veçori. Në radhë të parë, pa vonesë, bëhet pyetja e viktimës, këqyrja e vendit të ngjarjes, caktimi i ekspertit mjekoligjor i viktimës.

Policia kur i kryen veprimet me iniciativë dhe kur fajtori nuk dihet merr këto masa të shpejta: kërkimin e fajtorit, gjetjen e dëshmitarëve që kanë parë ngjarjen ose dëshmitarëve të tjerë, ndjekjen e fajtorit në bazë të “gjurmëve të freskëta” dhe mbi bazën e tyre, përdorimin e qenit policor. Në të njëjtën kohë ajo është e detyruar, pas parashikimit të tipareve të jashtme të dhunuesit, të dhëna nga viktimja, t’ua dërgojë policisë për ndjekje dhe ndalim në pikat më të rëndësishme të transportit. Shpesh personi i dyshuar ngre alibinë. Për vërtetimin e saj kryhet disa veprime hetimore të para, si paraqitja për njohjen e tij nga ana e viktimës dhe dëshmitarëve që kanë parë ngjarjen dhe, po të jetë e nevojshme, kryerja paraprake mjekoligjore e tij<sup>16</sup>

## **6. Marrja e provave, shqyrtimi dhe verifikimi i tyre**

Si rregull e përgjithshme, provat e mbledhura me rastin e marrëdhënieve seksuale me dhunë, duhet për së afërmi të pasqyrohen rregullat e mbledhjes së provave që administrohen të gjitha krimet e tjera. “Mjetet e kërkimit të provës janë veprime procedurale që kryhen për të individualizuar dhe për të siguruar prova në çdo fazë të procesit final. Veprimet procedurale që kryhen nga organi procedues konsistojnë në gjetjen e sendeve - provave materiale ose në njohjen e nevojshme për të provuar faktet që janë objekt i të provuarit në procesin penal. Mjetet e kërkimit të provës janë: këqyrjet, kontrolllet, sekuestrimet, etj.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2005, f. 625-626.

<sup>17</sup> E. Sahiti, *Argumentimi në procedurën penale*, Prishtinë, 2006, f. 145-146.

Megjithatë, në të gjitha rastet e veprave penale, pavarësisht nga specifikat e tyre, duhen kryer të gjitha këto veprime procedurale për kërkimin e provave.

Po ashtu, vetë natyra e krimeve i jep peshë nevojës për ekzamine speciale të teknikës kriminalistike. Mbledhja dhe shqyrtimi i provave me rastin e veprave penale kundër integritetit seksual veçanërisht me rastin e dhunimit, është e dizajnuar në mënyrë specifike për t'i ndihmuar teknikut kriminalist në mbledhjen dhe ruajtjen e gjërave provuese (provave). Në këtë mënyrë, si rregull i përgjithshëm, mbledhja e provave nga viktima e dhunimit apo sulmit seksual, bëhet nga ana e personelit të kualifikuar mjekësorë në ndonjë ent mjekësor.

### **7. Këqyrja e vendit të ngjarjes dhe rrethanat që ndikojnë në zbulimin dhe ndriçimin e kriminalitetit seksual**

Si detyrë kryesore e këqyrjes së vendit të ngjarjes padyshim që është studimi i ambientit ku ka ndodhë vepra penale, i mekanizmit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, zbulimi, mbledhja dhe fiksimi i gjurmëve dhe sendeve – provave materiale si dhe fiksimi i rezultateve që kanë dalë nga këqyrja e vendit të ngjarjes. Kështu që këqyrja e vendit të ngjarjes bëhet me qëllim që të vërtetohet se: të vërtetohet se a ekziston vepra penale apo jo; të vërtetohet llojin e veprës penale; të vërtetohet provat me qëllim që të gjendet kryerësi dhe të identifikohen provat për objektin, kohën, mënyrën, motivin e kryerjes si dhe rrethanat e tjera që janë të rëndësishme për të vërtetuar përgjegjësin e penale të kryerësit; të gjendet viktima dhe të vërtetohet identiteti i saj; të vërtetohet lloji dhe madhësia e dëmit që është shkaktuar me veprën penale; të kontrollohet të gjitha provat që janë në dispozicion. Për këtë qëllim, në shumicën e rasteve, zbatohet eksperimenti i ngjarjes si formë e posaçme e këqyrjes<sup>18</sup>.

Përveç këtyre detyrave, hetuesi kryen edhe disa detyra të tjera që kanë të bëjnë me sqarimin e disa rrethanave që kanë rëndësi të veçantë për çështjen penale. Nga një pikë e caktuar që ndodhet përtej kufijve të vendit të ngjarjes mund të shikohet ose të dëgjohet se çfarë ndodh në vendin e ngjarjes me qëllim që të gjenden dëshmitarë që kanë parë ngjarjen ose kanë dëgjuar se çfarë ka ndodhur. Sa i përket rrethanave

---

<sup>18</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 167-168.

që ndikojnë në zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale kundër integritetit seksual, me këqyrjen e vendit të ngjarjes mund të veçohen disa prej tyre: nëse është përdorur dhuna ndaj viktimës; nëse dhunën e ka përdorur personi që tregohet nga ana e viktimës; dhuna nuk është përdorur, por ka pasur marrëdhënie seksuale me vullnetin e lirë; marrëdhënia seksuale nuk ka pasur, kallëzimi i së dëmtuarës ose i të dëmtuarës është i rremë.

Kërkimi i gjurmëve dhe i sendeve - provave materiale – mbështetet në rolin e teknikës kriminalistike sipas së cilës, në procesin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, duhet të zgjidhet problemi se çfarë objektësh (duke gjykuar sipas rrethanave të çështjes) ka prekur fajtori, në cilin vend dhe në cilin objekt mund të lihen ato gjurmë.

Në këtë kontekst, intervenimi në vendin e ngjarjes duhet të bëhet menjëherë posa të merret njoftimi se është kryer vepra penale, ngase, mund të zihet në flagrancë kryerësi apo edhe duke ikur. Po ashtu, gjurmët të cilat ndodhen në vendin e ngjarjes mund të dëmtohen, largohen apo asgjësohen nga kryerësi apo ndonjë person tjetër. Policia sapo të arrijë në vendin e ngjarjes së pari shikon se a ka të lënduar dhe nëse ka duhet të ju ofrohet ndihma mjekësore menjëherë. Mandej, sigurimi i vendit të ngjarjes në mënyrë që mos të hyjnë personat e paautorizuar apo disa persona që janë kureshtarë, të cilët mund të kenë qëllime t'i dëmtojnë dhe asgjësojnë gjurmët e krimit. Po ashtu, ndalja e personave që gjenden në vend ngjarje që dyshohet se mund ta kenë parë ngjarjen, dhe të tillët mund të shërbejnë si dëshmitarë. Kërkimi i gjurmëve ndjek një radhë veprimesh të bashkërenduara. Grupi hetimor me rastin e kërkimit të gjurmëve duhet të ketë kujdes që të mos i prish gjurmët ekzistuese, po ashtu ai duhet të ketë kujdes që të mos ta lë gjurmën e tij në vendin e ngjarjes. Për tu realizuar ky qëllim i këqyrjes së vendit të ngjarjes përdoren metodat teknike të lëvizjes së grupit hetimor nga qendra në periferi ose nga periferia në qendër dhe metodat taktike të këqyrjes statike e dinamike të objekteve që ndodhen në këtë vend.

Këqyrja e vendit të ngjarjes zhvillohet nëpër disa etapa, një numër i madh i autorëve përmendin tri etapa të këqyrjes së vendit të ngjarjes (fazën e sigurimit të vendit të ngjarjes, fazën statike dhe fazën dinamike).<sup>19</sup>

Në fakt, këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor me anën e të cilit organi procedues percepton drejtpërsëdrejti mjedisin ku

---

<sup>19</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 174.

ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson, gjurmët e provat materiale dhe sqaron rrethanat që kanë rëndësi për çështjen. Ky veprim hetimor është njëherësh edhe burim i pasur informacioni me anën e të cilit sqarohet mekanizmi ngjarjes në bazë të gjurmëve, studiohet personaliteti i personave që kanë marrë pjesë në këtë ngjarje, veçanërisht veçoritë psikologjike të tyre.

Këqyrja e vendit të ngjarjes nga pikëpamja taktike mund të kryhet në të gjitha rastet kur në mjedisin ku ka ndodhur vepra penale janë shkaktuar ndryshime. Është rregull në kriminalistikë që nuk ka vepër penale që nuk lë shenja materiale.<sup>20</sup>

Sipas Dr. Estref Miftari, “Për zbulimin, marrjen dhe për ekzaminimin e gjurmëve materiale në rastin e këqyrjes së veprave penale, përdoren mjete dhe metoda të ndryshme. Ato vlerësohen gjenden në sasi relativisht të mëdha (të ashtuquajtura makrogjurmë), po ashtu edhe në sasi shumë të vogla (të ashtuquajtura mikrogjurmë). Teknika për zbulimin e gjurmëve të kontaktit në vendin e ngjarjes janë të thjeshta, këqyrja me sy të lirë ose me lentë zmadhuese. Në objekt nëse mendohet se duhet të ketë gjurmë të tilla, por nuk duken me sy të lirë, ushtrohet këqyrja me lentë zmadhuese në vendin e ngjarjes ose vetë objektet gjurmëmbajtëse dërgohen në laborator duke i paketuar në mënyrë të tillë që të mos bien pjesëza gjatë transportit”.<sup>21</sup>

Megjithatë, vetë natyra e këtyre krimeve i jep peshë nevojës për ekzaminime speciale të teknikës kriminalistike. Mbledhja e provave të marrëdhëniet seksuale me dhunë është e dizajnuar në atë mënyrë specifike për t’i ndihmuar teknikut kriminalist në mbledhjen dhe ruajtjen e provave nga viktimat e gjallë e dhunimit apo e sulmit seksual, bëhet nga personat e kualifikuar mjekësor në ndonjë ent mjekësor.<sup>22</sup>

### **8. Ekspertimi mjekoligjor dhe psikiatrik ligjor i viktimës**

Ekspertimi në marrëdhëniet seksuale me dhunë përbën një nga veprimet e para hetimore dhe kryhet për të zbuluar gjurmët që vërtetojnë marrëdhëniet seksuale me dhunë, karakterin dhe pasojat e veprimit të dhunës, shkalla e gravitetit të dëmtimeve trupore, infektimet me sëmundje veneriane (ngjitëse), etj.

Nëse e dëmtuara është zhvirgjëruar ose ka dështuar, koha e këtyre dëmtimeve dhe në rast se nuk ekziston ku dëmtim, a mund të

---

<sup>20</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, f. 322.

<sup>21</sup> E. Myftari, *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Tiranë, 1996, f. 141

<sup>22</sup> Ademaj, Xh, *Metodika e hetimit të krimit*, Prishtinë, 2006, f. 110, 111, 112, 113.

ketë pasur marrëdhënie pa u dëmtuar membrana; nëse ka gjurmë të freskëta të marrëdhënieve seksuale, karakteri dhe lokalizimi i tyre (në organin gjenital, në gjoks, kofshë); nëse në trupin e viktimës ka gjurmë dhune, lloji i lokalizimit, shkalla e gravitetit, vjetërsia dhe mekanizmi i shkaktimit të tyre; nëse e dëmtuara ka shenja të sëmundjes veneriane (ngjitëse), lloji i sëmundjes dhe vjetërsia e infektimit; nëse e dëmtuara është me barrë dhe prej sa kohësh; cili është grupi i gjakut të viktimës.

Ndërkaq, ekspertimi psikiatriko-ligjore i viktimës në praktikë, shpesh, nuk kërkohet nga organet kompetente. Megjithatë, kryerja e këtij lloji ekzaminimit ndihmon në zgjedhjen e shumë problemeve që kanë të bëjnë si me kallëzimin ashtu edhe me njohjen e personalitetin e femrës, nëse ajo vuan nga ndonjë sëmundje psikike që e shtynë atë të akuzojë personat e pafajshëm.

Për të gjitha veprimet e tjera hetimore operative- policore hetimore- gjyqësore në bashkëpunim me organet e zbulimit dhe të ndjekjes në territorin ku kryhen veprat penale kundër integritetit seksual duhet të sigurohen prova të mjaftueshme për kapjen e kryerësit. Po ashtu, duhet të zbatohet metoda e fotografimit dhe e regjistrimit etj. të vendit të ngjarjes dhe të shumë gjurmëve që kanë të bëjnë me krimin e hulumtuar.

Thënia se “një fotografi vlen më shumë se njëmijë fjale”<sup>23</sup>, është një pasuri e madhe që dokumenton saktësisht vendin e krimit. Kusht themelore është në këtë vend të mos lëviz asnjë objekt, derisa të fotografohet vendi i ngjarjes me metodat përkatëse të fotografisë kriminalistike. Kështu që fotografimi i vendit të ngjarjes bëhet me qëllim që të fiksohet mjedisi i vendit të ngjarjes, sendet që ndodhen në të, gjurmët e zbuluara dhe mjetet me të cilat është kryer vepra penale. Në praktikën botërore ky fiksion realizohet me fotografimin orientues, me fotografimin e pamjes së përgjithshme me fotografimin e objektit kryesor dhe me fotografimin e gjurmëve dhe sendeve.<sup>24</sup> Edhe në këso rastesh kërkohet që në vendin e ngjarjes të bëhen katër lloje fotografish.<sup>25</sup> Fotografia e parë është orientuese, ku përveç vendit të ngjarjes, paraqitet edhe tërë mjedisi përreth vendit të ngjarjes. Ky lloj fotografimi përdoret kryesisht në ato raste ku ngjarja ka ndodhur në territorin e hapur, të painedividualizuar.

---

<sup>23</sup> M. D. Lyman, *Criminal Investigation*, Usa, 193, f. 72-75.

<sup>24</sup> Xh. Ademaj, *Teknika kriminalistike*, Prishtinë, 2006, f. 119.

<sup>25</sup> Po, aty, f. 141.



Çështja e mbledhjes, fiksimit dhe ekzaminimit të gjurmëve materiale dhe të dëshmvive të tjera në rastet e zbulimit dhe ndriçimit të veprave penale kundër integritetit seksual është një nga anët më të vështira të grupit hetimor, mirëpo në drejtim të veprimit të kryerësit, veçohen edhe disa karakteristika gjithashtu të rëndësishme për zbulim.

Si rregull, çdo fajtor përdor të gjitha mjetet dhe mënyrat për të arritur te qëllimi kriminal, por edhe për ta mbuluar karakterin e vërtetë të ngjarjes, gjurmët e saj dhe për të falsifikuar provat. Përpjekjet e fajtorit për të mbuluar karakterin e vërtetë të ngjarjes bëhen: duke inskenuar një vepër penale për të mbuluar një vepër tjetër penale, p.sh. dhunimin e paraqesin si vepër penale edhe pse ka ndodh sipas pëlqimit të dy partnerëve etj. Fajtorët përveç tjerash bëjnë përpjekje edhe për t'i falsifikuar provat e këtë metodë e bëjnë duke hedhur sende ose duke lënë gjurmë që u përkasin personave të tretë.

Në praktikë njihet rasti kur fajtori ka lënë mjete që ka përdorur për të kapërcyer pengesat të cilat u përkisnin personave që punonin ose banonin pranë vendit të ngjarjes, si dhe shënime, fotografi, mjete pune me iniciale ose me përmbajtje të plotë të emrit, dokumentet të cilat i përkisnin një personi të caktuar. Me këto veprime fajtorët përpiqen të krijojnë përfytyrime të gabuara dhe situata të rreme.<sup>26</sup> Versioni mbi inskenimin e ngjarjes në tërësi dhe mbi falsifikimin e provave të veçanta është version i detyrueshëm që duhet të ngrihet edhe të verifikohet në çdo këqyrje në vendin e ngjarjes me rastin e veprave penale kundër integritetit seksual.

### **9. Marrja në pyetje e viktimës**

Marrja në pyetje e viktimës me rastin e marrëdhënieve seksuale me dhunë është një veprim hetimor i ndërlikuar, i cili kërkon nga hetuesi takt të madh po ashtu edhe mjeshtëri profesionale me rastin e pyetjes së viktimës. “Në këtë drejtim organi procedues ka për detyrë ta bind viktimën se jeta seksuale nuk është diçka e jashtëzakonshme dhe e turpshme, por krejt si diçka e natyrshme”. Sjellja korrekte e hetuesit, ngrohtësia e rrethana tjera ndikojnë që e dëmtuara t'i tregojë edhe hollësisirat më të thella që i interesojnë hetimit dhe zbulimit të së vërtetës”.<sup>27</sup>

---

<sup>26</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 1999, f. 321.

<sup>27</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e kriminit*, Prishtinë, 2006, f. 313.

Në këtë drejtim shtrohen disa rrethana dhe pyetje që duhen që të sqarohen si: ku, kur dhe në cilin vend është ushtruar dhuna; si është ndodhur viktima në vendin e ngjarjes; si shpreheshin veprimet me dhunë të fajtorit, dhunë fizike, dhunë psikike apo me përdorimin e armës; a e kreu fajtori aktin seksuale, çfarë gjurmësh mund të kenë mbetur në vendin e ngjarjes; a ka bërë kundërshtim viktima, ku pasqyrohet ky kundërshtim, çfarë gjurmësh ose mikrogjurmësh janë lënë në trupin, teshat e viktimës dhe, po të jetë e mundur, të fajtorit; nëse për këtë krim e dëmtuara (i dëmtuari) ka njoftuar ndonjë person, nëse ka bërë titur dhe kush e ka dëgjuar; nëse e dëmtuara, para dhunës, ka bërë jetë seksuale ose ka qenë në periudhën e paslindjes, ose në gjendje të dobët; nëse e dëmtuara ka shkuar në institucionin mjekësor për ndihmë; çfarë kishte veshur e dëmtuara dhe çfarë teshash mbante fajtori; kush mund t'i ketë parë të dëmtuarën, të dëmtuarin dhe fajtorin në vendin e ngjarjes ; nëse në vendin e ngjarjes ka gjurmë rezistente.<sup>28</sup>

Nëse fajtori është i panjohur, përveç pyetjeve të mësipërme, sqarohen edhe: tiparet e jashtme të kryerësit, përfshirë edhe ecja, gjestet, veçoritë e sjelljes së të dyshuarit (dialekti, zëri etj.) teshat e tij, po ashtu edhe sendet që ai mbante (syzet, sahati, shkrepsja, cigaret etj.); të dhënat për mjetin e transportit që ka pasur i dyshuari; veçoritë dhe sjelljet e të dyshuarit në vendin e ngjarjes (nëse është përpjekur ta fshehtë fytyrën, nëse mbante maskë, nëse mbulonte kokën). Kur fajtori njihet nga e dëmtuara sqarohen: emri, mbiemri, vendi i punës, detyra, banimi dhe të dhënat e tjera të personalitetit të tij; marrëdhëniet me të dëmtuarën (kur dhe kur janë njohur, nëse janë taktuar shpesh, nëse kanë pasur mosmarrëveshje dhe urrejtje të ndërsjella, nëse kanë qenë në raporte seksuale, nëse kanë pasur korrespondencë, kush di për marrëdhëniet e tyre, takimi i tyre ishte i rastit apo me marrëveshje, nëse janë takuar pas marrëdhënies seksuale me dhunë si dhe rrethana të tjera).<sup>29</sup>

Nga kjo që u tha rezulton se sqarimi i këtyre pyetjeve po dhe i rrethanave tjera që lidhjen me marrëdhëniet seksuale me dhunë kanë një rëndësi të madhe. Sqarimi i këtyre pyetjeve do të bën të mundshme të dihet se marrëdhënia seksuale a ka ndodhë me dhunë apo jo si dhe në zbulimin e kryerësit të veprës penale.

---

<sup>28</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, f. 626.

<sup>29</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 313-314.

### **9.1. Marrja në pyetje e personit të dyshuar**

Pyetja e personit të dyshuar ka rëndësi të madhe në sqarimin e rrethanave që dyshohet se kanë ndodhur me rastin e krimeve seksuale. Me të drejtë pohon Prof. V.Latifi se, “Marrja në pyetje e personit të dyshuar për herë të parë kryhet menjëherë pas ndalimit”. Megjithatë, pyetja e personit të dyshuar, si rregull, do të jetë më e suksesshme vetëm në ato raste pasi të kenë marrë fund veprimet e domosdoshme hetimore e të tjera me të cilat janë mbledhur provat e sigurta. Praktika tregon se ka raste kur personat e dyshuar pretendojnë se janë impotent, kështu që dëshirojnë të japin prova se ata nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale me dhunë. Në këto raste do të caktohet kontrolli mjekoligjor për të konstatuar se personi a ishte impotent apo jo. Marrja në pyetje e personit të dyshuar i ndihmon organit procedues në orientimin në mbledhjen e provave dhe me këtë rast është me rëndësi që gjatë marrjes në pyetje thëniet të regjistrohen me mjete teknike.

Ekzaminimi i personit të dyshuar, si, rregull i paraprin ekspertimi mjekoligjor, në ato raste kur ka rrezik që gjurmët mund të zhduken vetvetiu me dashje para se të kryhet ekspertimi. Te personat e dyshuar, përveç dëmtimeve në trup, mund të gjenden njolla gjaku, sperma, balt, qime floku, grimca tekstili, mbulesa, dysheku, që kanë kaluar nga kontakti me të dëmtuarën ose me mjedisin e vendit të ngjarjes. Siç dihet nga ky kontakt lihen mikrogjurmë pak të dukshme ose të padukshme. Marrja në pyetje e personit të dyshuar bëhet menjëherë pas ndalimit.

Kur personi i dyshuar nuk është i njohur dhe e mohon takimin me viktimën, para së gjithash, duhet sqaruar se ku ndodhej ai në kohën e kryerjes së krimit, me çfarë merrej në atë kohë dhe me cilin është takuar. Pastaj nga ai kërkohet të sqarohet se çfarë teshash kishte veshur, këpucësh etj. Nëse në tesha, në këpucë ka njolla, dëmtime, cili është burimi i tyre. Po ashtu duhet sqaruar nëse teshat janë pastruar, këpucët janë rregulluar.

Kur personi i dyshuar njihet nga viktimja, këshillohet që hetuesi t’i sqarojë raportet e tyre dhe cilët janë ata persona që mund t’i njohin këto raporte. Në raste kur i dyshuari nuk e mohon aktin seksual, por ngul këmbë se ai është kryer me vullnetin e viktimës, atëherë duhet mbledhur prova për të vërtetuar se ky akt është kryer me dhunë.

Në rastet se vërtetohet se përdorimi i dhunës dhe personi i dyshuar pohon, atëherë hetimi duhet të përqendrohet në mbledhjen e të gjitha provave që i vërtetojnë marrëdhëniet seksuale me dhunë<sup>30</sup>.

### **9.2. Marrja në pyetje e dëshmitarëve**

Pyetja e dëshmitarëve gjithashtu ka rëndësi të madhe për faktin se ata mund të japin informacione të çmueshme që do të ndikojnë në zbulimin dhe sqarimin e veprave penale-krimeve seksuale. Si dëshmitarë mund të pyeten: ata që e kanë parë në vendin e ngjarjes ose në afërsi të dëmtuarën për personin e dëmtuar; ata që kanë qenë të pranishëm në kohën e marrëdhënieve seksuale me dhunë ose rrethanave të tjera që lidhen me krimin; ata që dinë rrethanat e ngjarjes, të maskuara nga vetë viktima dhe personi i dyshuar etj.<sup>31</sup> Në pyetjen e tyre sqarohen: rrethanat e kryerjes së veprës penale-krimeve seksuale që e kanë parë apo kanë dëgjuar nga viktima ose persona të tjerë; ku, kur dhe në çfarë i tha viktima për faktin e dhunës, në çfarë gjendje ndodhej viktima në atë çast, veshja e saj sendet personale etj.; cili është personaliteti i viktimës, i personit të dyshuar, rrethi i personave që i njohin, interesat, jeta që bëjnë, zanatet, pasionet etj.; kush mund të jetë dëshmitarë tjetër etj.<sup>32</sup>

Metodat taktike të pyetjes së dëshmitarëve në këto krime caktohet duke mbajtur parasysh këto kritere: shkallën e njohjes së raporteve ndërmjet viktimës dhe personit të dyshuar, lidhjet (gjinie, shoqërore) që kanë me ta etj. Ecuria e pyetjes dhe rregullat taktike me të cilat mbështetet pyetja duhet të jenë të harmonizuara me specifikat e këtij lloji të kriminalitetit si dhe ndërlikueshmëria e pozitës që ka viktima.

Si rrjedhim, nga e gjithë kjo që u tha konkludoi se zbulimi i kriminalitetit seksual pa ndërmarrjen e masave dhe veprimeve kriminalistike e hetimore si dhe metodave të tjera kriminalistike nuk do të ishte i mundur zbulimi dhe ndriçimi i suksesshëm i tij.

### **Conclusions**

In this paper, we concluded that the discovery and successful lighting of sexual crime has a great importance in combating and preventing them. Of course this makes it possible to reduce the “dark number” which also means a successful defense against this form of

---

<sup>30</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 314.

<sup>31</sup> V. Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2006, f. 314.

<sup>32</sup> S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, 2004, f. 629.

criminality. So, at this preliminary stage of the proceedings conducted intensive activity and operative police but also other bodies, which take a series of actions in terms of detection and illumination of crimes against sexual integrity.

And in the discovery stage, lighting and proving sexual criminality, the role of the police is inevitable, so it is very large. At this stage of discovery undertaken a series of actions and measures operative-contemporary tactical and other forensic methods to detect these crimes and apprehend their perpetrators. This activity is based on collecting intelligence information, data, verify their versions building, comparing their elimination processing and other criminal measures. The discovery of offenses, including sexual crime, concerns the activity of the police, but also other organs repression- prosecution and courts.

I believe that great importance in the detection, lighting and proving sexual crime great importance are taking measures and actions criminal, such as inspection, checks, taking of evidence and consideration of their examination of the scene, photographing and recording technical means, as well as other criminal methods. These forensic tools and methods should be used and treated successfully in a professional manner which is a prerequisite for detecting the brightness of the successful sexual crime.

### **Literatura**

#### **Libra dhe publikime të shfrytëzuara dhe të cituara**

Latifi, V, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimin, Prishtinë, 2006.

Begeja, Skender, Kriminalistika, Tiranë, 1999.

M. D. Lyman, Criminal Investigation, Usa, 1993.

Ademaj, Xh, Teknika Kriminalistike, Prishtinë, 2006.

Myftari, E, Këqyrja e vendit të ngjarjes, Tiranë, 1996.

Ademaj, Xh, Metodika e hetimit të krimin, Prishtinë, 2006.

Sahiti, E, Argumentimi në procedure penale, Prishtinë, 2006.

Sahiti, E, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.

Vodeneliq, V, Kriminalistika, Prishtinë, 1970.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Haziri, Fatos, E drejta e Policisë, Prishtinë, 2010.

Latifi, Vesel, Taktika kriminalistike, Prishtinë, 2001.

Latifi, Vesel, Kriminalistika, Prishtinë, 2011.

## CENTRUM 5

---

Shishani, Fitim, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, Prishtinë, 2006.

Kosta, Arqile, Etika e Policisë, Tiranë, 2004.

Yzeiri, Bajram, Manaxhimi i Policisë, Tiranë.